

Ne ju ofrojmë ndihmë

Platforma kundër trafikimit me qenie njerëzore zhvillon një program të veçantë mbështetjeje i cili të jep ty ndihmë, edhe atëherë kur shoqëria nuk e bën atë. Ne madje i pranojmë edhe fëmijët tuaj në program. Ndiha jonë është pa kosto dhe pa kushte - pa marrë parasysh nëse banon në Suedi pa letra dhe nëse nuk do të bashkëpunosh me policinë. Ndiha jonë bazohet në nevojat tuaja dhe në aftësinë tonë - pa u përzier institucionet, po qe se ju ashtu doni.



PLATTFORMEN MOT MÄNNISKOHANDEL

Do ndihmë dhe informacion?

Kontakto Platformën kundër trafikimit me qenie njerëzore përmes faqes sonë të internetit www.manniskohandel.se

Posta elektronike është info@manniskohandel.se

KUJDES! Ne raste urgjente thërrisni policinë në numrin telefonik 112

Sekretariati Kombëtar kundër Prostitucionit dhe Trafikimit të Qenieve Njerëzore mund të ndërmjetësojë këshilla dhe informacion tek institucionet, komunat dhe organizatat vullnetare te cilat takojnë viktimat. Telefoni **Hotline 020-390 000**

PLATFORMA KUNDËR TRAFIKIMIT ME QENIE NJERËZORE

NE TË JAPIM ALTERNATIVË

Të gjithë njerëzit kanë të drejtë për një jetë të denjë, të lirë, pa detyrime dhe kontroll.

- **Nëse ti nuk mundesh** të bësh negociata rreth kushteve të punës, nuk të jepet rroga dhe nuk mundesh të japësh dorëheqje dhe nuk mund të ikësh.
- **Nëse nuk ndihesh** e/i sigurt për të ndikuar jetën tënde ose nuk të lejohet te vendosësh mbi trupin tënd.

Atëherë kjo nuk është ok!

Kjo mund të jetë trafikim me qenie njerëzore.

SHQIPTAR / ALBANSKA

Ky është trafikim me qenie njerëzore

Je e/i detyruar apo mashtruar të shesësh sex, të punosh pa pagese, të vjedhësh apo te kryesh vepra të tjera penale apo te lypësh? Kjo është trafikim me qenie njerëzore. Kjo nuk është në rregull. Te gjithë kanë të drejtë të jetojnë në liri.

Askush nuk ka të drejtë të nxisë dikë tjetër të veprojë për përfitimim e tyre, qefin apo dëshirën. Ai i cili e nënshton tjetrin me këto veprime thyen ligjin suedez dhe të drejtat e njeriut.



Çfarë të drejtash ke ti?

Ti ke të drejtë ndihme nëse je viktimë e trafikimit me qenie njerëzore. Ke të drejtë të kesh:

- ✓ Banesë të përshtatshme dhe të sigurt
- ✓ Mbështetje materiale (ushqim dhe rroba, etj.)
- ✓ Ndihe të shëndetësore të nevojshme
- ✓ Mbështetje psikologjike
- ✓ Këshillim juridik dhe informacion
- ✓ Përkthime me shkrim dhe me gojë

Objektivi jone është që t të japim qasje në të drejtat e njeriut. Ne të cilët punojmë për këtë, bashkëveprojmë në organizatën Platforma kundër trafikimit me qenie njerëzore. Bashkë, ne duam t'ju ofrojmë ndihmë dhe mbrojtje, ty, fëmijëve të tu dhe familjes tënde. Ç' do ndihmë jepet pa kosto dhe bazohet nga nevojat tuaja.

Disa nga ata që kanë marrë ndihmë:

Bullgarja Evelina u detyrua të punojë te gjitha ditët e javës pa pagesë. Ajo kërkoi dhe gjeti vetë një qendër ndihme për të dalur nga situata. Ajo mori ndihmë për të gjetur një vend të sigurt për të jetuar, ushqim, pushim dhe rroba. Ajo mori informacion rreth të drejtave të saja dhe rreth mundësive alternative.

Rumunja Nadja u zbulua nga policia kur ajo ishte duke kërkuar blerësit e seksit. Nadja u vendos në një banim ku ajo mori ndihmë të rimëkëmbet pas eksploatimit në prostitucion. Fëmijët e saj morën gjithashtu ndihmë për të përpunuar atë çka kishin parë dhe përjetuar dhe Nadja u ndihmua për të bërë kallëzim penal.

Shqiptarja Anxa u grabit dhe u drogua nga një ligë e organizuar e cila e detyroi atë të shfrytëzohet në prostitucion. Shtatzënë, ajo iku për në Suedi me djalin e saj 3 vjeçar. Ajo, përmes programit mbështetës së Platformës mori banim, mbështetje bisedore, informacion, rroba, ushqim dhe ndihmë me proçesin e azilit.